



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Metodat dhe teknikat sasiore në kërkim shkencor
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (sem. II)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vleranëkredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
Kursi është i dizajnuar që të japë studentëve konceptet kryesore dhe karakteristika të tjera për të kuptuar dhe interpretuar si duhet metodat sasiore për analiza ekonomike, financiare, menaxheriale, operative etj. Ndërsa duke ilustruar materialet me disa situata të improvizuara në bazë të konteksteve të simuluar, kursi ka për qëllim që të ofrojë një material, i cili ju mundëson dhe lejon studentët për të punuar me një qasje praktike në zbatimin e koncepteve të diskutuara analitike me metodat e avancuara dhe bashkohore. Matjet shkencore të koncepteve ekonomike si në nivelin makro ashtu edhe në nivelin mikro do të zhvillohen nëpërmjet softuerëve SPSS.	
Qëllimet e lëndës:	
Objektivi kryesor i kursit është që të thellojnë njohuritë e studentit mbi metodat dhe teknikat sasiore të hulumtimit; për të përshkruar dhe shpjeguar procesin e zbatimit të metodave dhe teknikave sasiore të hulumtimit; për të përshkruar funksionin e metodave dhe teknikave sasiore të zbatuara në hulumtime kërkimore.	
Rezultatet e pritura të nxënies:	
Njohuri (NJ): *NJ1: Zotëron njohuri të avancuara mbi statistikat deskriptive dhe rregullimin e të dhënave, duke qenë në gjendje të paraqesë dhe interpretojë të dhënat në formë të strukturuar. *NJ2: Zotëron njohuri mbi analizën e variancës (ANOVA, MANOVA, ANCOVA) dhe përdor këto metoda për të identifikuar dallimet midis grupeve të ndryshme të të	

	dhënave në kontekst shkencor. *NJ3: Zotëron njohuri mbi analizën faktoriale, duke përdorur këtë metodë për të identifikuar strukturën e fshehur të të dhënave komplekse dhe për të reduktuar dimensionet e tyre. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Aplikon teste parametrike dhe joparametrike për testimin e hipotezave shkencore, duke vlerësuar rezultatet e kërkimit bazuar në modele të sakta statistikore. **A-K2: Përdor analizën e korrelacionit për të matur marrëdhëniet ndërmjet variablave dhe për të interpretuar forcat e lidhjeve mes tyre. **A-K3: Kryen analizën e regresionit linear dhe logjistik, duke qenë në gjendje të interpretojë dhe parashikojë tendencat e të dhënave dhe marrëdhëniet ndërmjet variablave të pavarur dhe të varur. **A-K4: Aplikon analizën e besueshmërisë për të vlerësuar saktësinë dhe konsistencën e rezultateve të hulumtimit në mënyrë të qëndrueshme dhe të besueshme. **A-K5: Përdor metoda të avancuara statistikore për të kryer analiza komplekse dhe për të vlerësuar rezultatet e hulumtimeve empirike në fushën e kërkimit shkencor. Aftësi (A): ***A1: Zhvillon aftësi të komunikimit dhe prezantimit përmes prezantimit të punimeve hulumtuese dhe analizave statistikore të kryera në grup. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet tëkorrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	3	5	15
Kollokfiume, seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë	3	5	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në	2	5	10

shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi.			
Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupe, punimit hulumtues, vetëvlerësimeve periodike, etj. Prezantimi i temës mësimore në Power Point. Përsëritja e temës paraprahe nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe të organizatat jofitim prurëse.		
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 - 30% • Testi i dytë vlerësues: 0 - 30% • Punimi hulumtues: 0 - 30% • Interaktiviteti, detyrat e shtëpisë dhe angazhimet tjera 0 – 10% ose • Provimi përfundimtar: 0 - 70%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ Grup Autorësh – Teknikat Statistikore me Shumë Ndryshore me Aplikim në SPSS, (Botimi i Gjashtë, 2017), 1 – 490. ▪ Donald R. Cooper & Pamela S. Schindler – Business Research Methods, McGraw-Hill Irwin, 2011.		
Literatura shtesë:	▪ Bob Matthews dhe Liz Ross, 2010, Metodatat e hulumtimit – udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, Centre for Democratic Education (Qendra për Edukim Demokratik), Tiranë. (Përkthyer nga anglishtja: Majlinda Nishku dhe Ilir Nishku). ▪ Quantitative Research Methods: From Theory To Publication Dr. Nicholas Harkiolakis, CreateSpace Independent Publishing Platform, 2021, 261 ISBN-13: 978-1543148138		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjerata që do të zhvillohet		

Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Rregullimi, paraqitja e të dhënave dhe statistikat deskriptive
Java e tretë:	Testimi i hipotezave dhe testet e hipotezave parametrike
Java e katërt:	Testet e hipotezave joparametrike
Java e pestë:	Analiza e korrelacionit
Java e gjashtë:	Analiza e variancës (ANOVA)
Java e shtatë:	Analiza e shumëfishtë e variancës (MANOVA)
Java e tetë:	Analiza e kovariancës (ANCOVA)
Java e nëntë:	Testi i parë vlerësues
Java e dhjetë:	Analiza e regresionit linear
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza e regresionit logjistik
Java e dymbëdhjetë:	Analiza faktoriale
Java e trembëdhjetë:	Analiza e besueshmërisë
Java e katërmëdhjetë:	Testi i dytë vlerësues
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezentimi i punimeve hulumtuese

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Politikat e mirësjelljes konform statutit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e mjetit identifikues në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.